



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR			
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA			
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING			
Nr. Org. Org. Jemica Org. Unit	M-01	Nr. Prot. Prot. No.	6859/19
Nr. faqeve Broj stranica No. pages	- 36 -	Data Datum Date	21.11.19
Prishtinë / a			

UDHËZIM ADMINISTRATIV MMPH – NR. 12/19 PËR NDARJEN DHE REGJISTRIMIN E PARCELËS

ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MESP - NO. 12/19 FOR DIVISION AND REGISTRATION OF PARCELS

ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA MŽSPP – BR. 12/19 O DEOBI I UPISIVANJU PARCELE

<p>Ministri i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,</p> <p>Në mbështetje të Nenit 8, paragrafi 2 dhe Nenit 14, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Kadastër Nr. 04/-L-013, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.13/01, 01.09.2011) ,nenit 8, nënparagrafi 1.4. të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive(Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 1, 18.04.2011) dhe nenit 38, paragrafi 6 të Rregullores Nr.09/2011 të Punës së Qeverisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Nr. 15, 12.09.2011),</p> <p>Nxjerr,</p> <p style="text-align: center;">UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR NDARJEN DHE REGJISTRIMIN E PARCELËS</p> <p style="text-align: center;">Neni 1 Qëllimi</p> <p>Ky udhëzim administrativ ka për qëllim të rregulloj procedurat për ndarjen, bashkimin dhe regjistrimin e parcelës si dhe tarifatat për shërbimet dhe dhënien e informatave kadastrale për parcelë.</p>	<p>Minister of the Ministry of Environment and Spatial Planning,</p> <p>Pursuant to Article 8, paragraph 2 and Article 14, paragraph 1 and 2 of the Law on Cadastre Nr. 04 / -L-013, (Official Gazette of the Republic of Kosovo No.13 / 01, 01.09.2011), Article 8, subparagraph 1.4. of Regulation No.02 / 2011 on the areas of administrative responsibility of the Office of the Prime Minister and Ministries (Official Gazette of the Republic of Kosovo No.1, 18.04.2011) and Article 38, paragraph 6 of Regulation No. 09/2011 on Government Work (Official Gazette of the Republic of Kosovo. No. 15, 12.09.2011).</p> <p>Issue,</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVE INSTRUCTION FOR DIVISION AND REGISTRATION OF PARCELS</p> <p style="text-align: center;">Article 1 Purpose</p> <p>This Administrative Instruction aims to regulate procedures for division and registration of parcels as well as tariffs for issuing the cadastral informations for parcels.</p>	<p>Ministar Ministarstva Životne Sredine i Prostornog Planiranja,</p> <p>Na osnovu Čl. 8. stav 2, Čl. 14. stav 1 i 2, Zakona Br. 04/-L-013 o katastru, „Službeni list Republike Kosovo, Br. 13/01, 01.09.2011 god.) , Čl. 8. podstav 1.4. Uredbe Br. 02/2011 o poljima i administrativnim odgovornostima Kancelarije Premijera i ministarstava (Službeni list Republike Kosovo, Br. 1, 18.04.2011 god.), te Čl. 38. stav 6, Uredbe Br. 09/2011 Rada Vlade (Službnei list republike Kosovo, Br. 15, 12.09.2011 god.),</p> <p>Donosi,</p> <p style="text-align: center;">ADMINISTRATIVNOG UPUTSTVA O DEOBI I UPISIVANJU PARCELE</p> <p style="text-align: center;">Član 1 Svrha</p> <p>Ovo Administrativno Uputstvo ima za svrhu da reguliše postupke, spajanje te upisivanje parcele, kao i tarife za usluge te davanja katastarskih informacija za parcelu.</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;">Neni 2 Fushëveprimi</p> <p>Dispozitat e këtij udhëzimi administrativ janë të detyrueshme për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, zyrat kadastrale komunale, gjeodetët e licencuar, kompanitë e licencuara, teknik gjeodet i licencuar dhe parashtruesit e kërkesave për shqyrtim.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2 Scope</p> <p>The provisions of this Administrative Instruction are binding for Kosovo Cadastral Agency, Municipal Cadastral Offices, Licensed Surveyors, Licensed Companies, Technician surveyor, and Applicants of requests for review.</p>	<p style="text-align: center;">Član 2 Delokrug</p> <p>Određbe ovog Administrativnog Uputstva su obavezujuće za Kosovsku katastarsku agenciju, opštinske katastarske kancelarije, licencirane geodete te licencirane geodetske kompanije, licencirane geodetske tehničare i podnosiocē zahteva za razmatranje.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3 Përkufizimet</p> <p>1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këtë kuptim:</p> <p>1.1. Ndarja e njësisë kadastrale – nënkupton procesin e krijimit të njësisë kadastrale, me ndarjen e njësisë kadastrale në dy e më shumë njësi;</p> <p>1.2. Raporti gjeodezik- nënkupton dokumentacionin teknik gjeodezik për punët e kryera themelore gjeodezike, matjen e pronave të paluajtshme në funksion të kadastrës së paluajtshmërive dhe në funksion të mbajtjes së kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës, punëve gjeodezike për dedikime të veçanta, të cilat janë me ndikim për kadastrën e paluajtshme dhe punëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 3 Definitions</p> <p>1. The used expressions in this Administrative Instruction have this meaning:</p> <p>1.1. Division of cadastral units –means the process of establishing the cadastral unit, with the division of the cadastral unit into two or more units;</p> <p>1.2. Geodetic report- means geodetic technical documentation for main geodetic done works, measurement of real estate in function of the estate cadaster and in function of retention of state border of Republic of Kosovo, geodetic affairs for particular impact, which influence the real estate cadaster and geodetic affairs, in function of preparing geographical maps;</p>	<p style="text-align: center;">Član 3 Definicije</p> <p>1. Izrazi korišćeni u ovom Administrativnom Uputstvu imaju sledeće značenje:</p> <p>1.1. Deoba katastarske jedinice – podrazumeva proces stvaranja katastarske jedinice, deljenjem katastarske jedinice na dve i više jedinica;</p> <p>1.2. Geodetski izveštaj – podrazumeva geodetsko-tehničku dokumentaciju za izvođene osnovne geodetske radove, merenje nepokretnih imovina u funkciji katastra nepokretnosti i u funkciji održavanja državne granice Republike Kosovo, geodetskih radova za posebne namene, koji su od utecaja za katastar nepokretnosti i geodetskih poslova, u funkciji pripremanja geografskih karata;</p>

<p>gjeodezike, në funksion të përgatitjes së hartave gjeografike;</p> <p>1.3. Ligj - nënkupton Ligji Nr. 04/L-013 për Kadastër;</p> <p>1.4. Njësi kadastrale - nënkupton përshkrimin grafik dhe tekstual të parcelës, ndërtesës, pjesës së ndërtesës dhe përçojat. Çdo njësi kadastrale ka një numër identifikues unik si dhe atributet e specifikuar në këtë ligj;</p> <p>1.5. Të dhënat grafike – nënkuptojnë vizatimin gjeometrik të njësisë kadastrale, i cili përmban numrin identifikues unik;</p> <p>1.6. Sipërfaqja e njësisë kadastrale - nënkupton sipërfaqën e njësisë kadastrale, e llogaritur përmes koordinatave të pikave të kufirit të njësisë në projektionin hartografik;</p> <p>1.7. Sistemi i Informacionit Kadastrale të Tokave në Kosovë (SIKTK) – nënkupton sistem i informacionit të integruar dhe unik në Kosovë, që mundëson grumbullimin, përpunimin, mirëmbajtjen, menaxhimin, shfrytëzimin, shpërndarjen, lëshimin dhe çasje të vetme</p>	<p>1.3. Law - means Law no. 04/L-013 for Cadaster;</p> <p>1.4. Cadastral unit- means textual and graphical description of the parcel, building, building part and conductor. Each cadastral unit has a unique identifying number and attributes that are specified in this law;</p> <p>1.5. Graphical data – means geometric drawing of cadastral unit, which contains unique identifying number;</p> <p>1.6. Surface of Cadastral unit –means the area of cadastral unit, calculated through the coordinates of borders’ unit points in cartographic projection;</p> <p>1.7. Cadastral Information System of Lands in Kosovo (CISLK) – means the integrated and unique information system in Kosovo, which enables the collection, processing, maintenance, management, utilization, distribution, release and single access in all the data from: official</p>	<p>1.3. Zakon – podrazumeva Zakon Br. 04/L-013 o Katastru;</p> <p>1.4. Katastarska jedinica – podrazumeva grafički i tekstualni opis parcele, zgrade, posebnog dela zgrade i vodove. Svaka katastarska jedinica ima jedan jedinstveni identifikacioni broj kao i attribute specificirane ovim zakonom;</p> <p>1.5. Grafički podaci – podrazumevaju geometrijski crtež katastarske jedinice, koji sadrži jedinstveni identifikacioni broj;</p> <p>1.6. Površina katastarske jedinice – podrazumeva površinu katastarske jedinice, obračunata kroz koordinate graničnih tačaka jedinice u kartografskoj projekciji;</p> <p>1.7. Sistem katastarskih informacija o zemljištu na Kosovu (SKIZK) – podrazumeva sistem integrisanih i jedinstvenih informacija na Kosovu, koji omogućava prikupljanje, obradu, vođenje, upravljanje, korišćenje, distribuciju, izdavanje i jedinstveni pristup podacima iz: zvaničnog sistema informacija o</p>
---	---	--

<p>në të dhënat nga: sistemi zyrtar i informacioneve të pronës së paluajtshme, punët esenciale gjeodezike, punët gjeodezike për dedikime të veçanta, matja e paluajtshmërive në funksion të kadastrit të paluajtshmërive, matja dhe mirëmbajtja e kufirit shtetëror të Republikës së Kosovës, hartat topografike, regjistrin e njësive hapësinore, të dhënat grafike të rrugëve dhe numrave të shtëpive, të dhënat grafike të tokës ndërtimore dhe të dhëna tjera të rëndësishme për paluajtshmëritë;</p> <p>1.8. TIK – Teknologjia e Informacionit;</p> <p>1.9. DRC – qendra e rimëkëmbjes së të dhënave.</p> <p>1.10. Gjeodet – nënkupton personin fizik dhe i regjistruar si biznes individual të licencuar për kryerjen e punëve kadastrale dhe gjeodezike;</p> <p>1.11. Kompani Gjodete – nënkupton personin juridik të licencuar për kryerjen e punëve kadastrale dhe gjeodezike;</p> <p>1.12. Teknik gjeodet – nënkupton personin fizik i cili licencohet sipas UA për licenca.</p>	<p>information system of real estate, essential geodetic affairs, geodetic affairs for special purposes, measurement of real estates in function of real estates cadastrals, measurement and maintenance of state border of Republic of Kosovo, topographic maps, register of spatial units, graphical data of streets and houses' numbers, graphical data of constructed land and other important data for real estate:</p> <p>1.8. IT – Information Technology;</p> <p>1.9. DRC – Recovery center of data</p> <p>1.10. Surveyor– means the physical person and the registered one as an individual licensed business, for conducting cadastral and geodetic affairs;</p> <p>1.11. Surveying Company – means the legal, licensed person for conducting cadastral and geodetic affairs;</p> <p>1.12. Technician Surveyor – means physical person who is licensed pursuant to AI for Licences.</p>	<p>nepokretnostima, osnovne geodetske radove, geodetske radove posebne namene, premer nepokretnosti u funkciji Katastra nepokretnosti, premer i održavanje državne granice Republike Kosovo, topografske karte, Registar prostornih jedinica, grafičke podatke ulica u kućnih brojeva, grafičke podatke o građevinskim zemljištima i druge važne podatke o nepokretnostima;</p> <p>1.8. ITK – Informaciona tehnologija;</p> <p>1.9. DRC- centar za oporavak podataka.</p> <p>1.10. Geodeta – podrazumeva fizičko lice koje je registrovano kao samostalno preduzeće licencirano za obavljanje katastarskih i geodetskih radova;</p> <p>1.11. Geodetska kompanija – podrazumeva pravno lice koje je licencirano za obavljanje katastarskih i geodetskih radova;</p> <p>1.12. Geodeta tehničar – podrazumeva fizičko lice, licenciran prema AU-om za Licence.</p>
---	--	--

<p>2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë kuptimin si në përkufizimet e Ligjit për Kadastër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 4 Përmbajtja e kadastrit</p> <p>1. Kadastrit përbëhet nga regjistri i njësive kadastrale, i të drejtave pronësore mbi njësitë themelore dhe hartës kadastrale, të cilat mbahen në formë analoge dhe digjitale.</p> <p>2. Njësitë themelore të kadastrit janë të përcaktuara në nenin 7, paragrafi 2 i Ligjit.</p>	<p>2. Other expressions used in this Administrative Instruction have the meaning as in definitions of Law For Cadaster.</p> <p style="text-align: center;">Article 4 Cadasters content</p> <p>1. Cadaster consists of the register of cadastral units and property rights upon those units, cadastral maps, which are held in analogue and digital form.</p> <p>2. The basic units of the cadastre are defined in Article 7, paragraph 2 of the Law.</p>	<p>2. Drugi izrazi koji su korišćeni u ovom Administrativnom uputstvu imaju isto značenje kao u definicijama Zakona o Katastru.</p> <p style="text-align: center;">Član 4 Sadržaj katastra</p> <p>1. Katastar se sastoji od registra katastarskih jedinica i imovinskih prava na te jedinice, katastarskih karti, koje se čuvaju u analognim i digitalnom obliku.</p> <p>2. Osnovne jedinice katastra su određene prema Čl. 7. stav 2, Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Parcela</p> <p>1. Parcela përmban:</p> <p>1.1. kodin e zonës kadastrale;</p> <p>1.2. numrin e parcelës;</p> <p>1.3. kufirin e parcelës;</p> <p>1.4. sipërfaqen;</p> <p>1.5. të dhënat për pronarin, apo shfrytëzuesin e regjistruar;</p> <p>1.6. vendi i quajtur.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Parcel</p> <p>1. Parcel contains:</p> <p>1.1. cadastral zone code;</p> <p>1.2. number of the parcel;</p> <p>1.3. border of parcel;</p> <p>1.4. surface;</p> <p>1.5. data for the owner and/or the registered exploiter;</p> <p>1.6. named place.</p>	<p style="text-align: center;">Član 5 Parcela</p> <p>1. Parcela sadrži:</p> <p>1.1. šifru katastarske zone;</p> <p>1.2. broj parcele;</p> <p>1.3. granicu parcele;</p> <p>1.4. površinu;</p> <p>1.5. podatke o vlasniku i/ili registrovanom korisniku;</p> <p>1.6. naziv mesta.</p>

<p align="center">Neni 6 Ndarja, bashkimi dhe regjistrimi i parcelës</p>	<p align="center">Article 6 Registration of the Parcel</p>	<p align="center">Član 6 Upis parcele</p>
<p>1. Krijimi i parcelave të reja kryhet përmes ndarjes ose bashkimit.</p> <p>2. Ndarja apo bashkimi i parcelave mund të regjistrohet vetëm:</p> <p>2.1. nëse parcelat janë të lira nga hipotekat dhe ngarkesat tjera;</p> <p>2.2. nëse kreditori apo poseduesi i të drejtave pronësore ka dhënë pëlqimin e tij për një rend të ri të prioriteteve në parcelën e re;</p> <p>2.3. nëse ekzistojnë hipoteka apo barra tjera të regjistruara me kreditor të ndryshëm në parcelat të cilat bashkohen, atëherë e drejta e hipotekës apo barrave tjera realizohet në njësinë kadastrale të re nga kreditorët në përpjestim me hipotekimin apo barrën fillestare të regjistruar.</p> <p>3. Në zonat urbane krijimi i parcelës bëhet pavarësisht planit urbanistik për qëllime të ndarjes së pronësisë apo krijimit të bashkëpronësisë.</p>	<p>1. The creation of new parcels is done by dividing or merging parcels.</p> <p>2. The division or combination of parcels can be registered only if:</p> <p>2.1. if parcels are free from any mortgage and other charges;</p> <p>2.2. if the creditor or the owner of property rights agrees for new priorities in the new parcel;</p> <p>2.3. if there exist mortgages or other registered charges, with different creditors in the parcel that will be combined, then the right of a mortgage or other charges, will be fulfilled in the new cadastral unit from creditor, in proportion with the mortgage or initial registered charge.</p> <p>3. In the urban areas the creation of parcels is made regardless urban plan for purposes of division of ownership or creation of co-ownership.</p>	<p>1. Osnivanje novih parcela vrši se deobom ili spajanjem.</p> <p>2. Deoba ili spajanje parcela može se registrovati samo:</p> <p>2.1. ako su parcele oslobođene iz hipoteka i drugih zaduženja;</p> <p>2.2. ako su poverilac ili nosilac imovinskih prava dali svoju saglasnost za novi raspored prioriteta u novoj parceli;</p> <p>2.3. ako postoje hipoteke ili druga registrovana zaduženja, sa različitim poveriocima u parcelama koje se spajaju, onda pravo na hipoteku ili druga zaduženja ostvaruje se od poverilaca u novoj katastarskoj parceli u srazmeri sa hipotekom ili početnom registrovanim zaduženjem.</p> <p>3. U urbanim zonama stvaranje parcele se obavlja nezavisno od urbanističkog plana, za svrhe deljenja vlasništva ili stvaranja suvlasništva.</p>

<p>3.1. Kur ndarja ose bashkimi i parcelave nga paragrafi 3 bëhet për qëllim të ndërtimit, para se të merret leja e ndërtimit pronari, investitori ose personi tjetër i autorizuar është i obliguar që paraprakisht të krijoj gjendjen juridike dhe kadastrale sipas planit urbanistik.</p> <p>4. Ndarja e bashkëpronësisë në zonat urbane në rastet kur është e regjistruar në kadastrë pjesa e pronësisë në sipërfaqen e parcelës dhe për të njëjtën ekziston akti noterial me sipërfaqen dhe lokacionin e përcaktuar në të, e cila mund të identifikohet në terren, bëhet vetëm me pëlqimin e fqinjëve të asaj pjese të parcelës.</p> <p>5. AKK është e obliguar që të nxjerr kornizë të veçantë të punës sipas paragrafit 4 të këtij neni, pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi administrativ.</p> <p>6. Në rastet kur kërkohet të bashkohen prona me pronarë të ndryshëm, krijimi i bashkëpronësisë bëhet vetëm në parcelën e formuar me bashkim, e cila duhet të krijohet paraprakisht me dokument të plotfuqishëm nga organi kompetent.</p>	<p>3.1. when separation or union parcels form article 3 is made for intention of construction, before the licence of construction is obtained, investor or other authorized person is obliged in advance to create juridical and cadastral status according to urban plan.</p> <p>4. The division of joint ownership in urban areas in cases where the part of ownership of the parcels surface is registered in the cadastre and there is a notarial deed with the surface and location specified in it, which can be identified on the ground, shall be done only with the consent of the neighbors of that part of the parcel.</p> <p>5. KCA is obliged to issue a special framework of work pursuant to paragraph 4 of this Article after the entry into force of this Administrative Instruction.</p> <p>6. In case it will be required to be united the property with the different owner, the creation of co-ownership is made only in parcels that are created with union, which must be created in advance with powerful document from competent organ.</p>	<p>3.1. Kada deoba ili spajanje parcela iz stava 3. ovog člana, se vrši u svrhe izgradnje, pre nego se uzima građevinska dozvola, vlasnik, investitor ili drugo ovlašćeno lice, dužno je da, prethodno, stvori pravno i katastarsko stanje prema urbanističkom planu.</p> <p>4. Deoba suvlasništva u urbanim zonama, u slučajevima kada je upisan u katastar deo vlasništva nad površinom parcele i za istu postoji notarski akt, sa površinom i lokacijom određene istim i koja se može identificirati na terenu, vrši se samo sa saglasnošću suseda tog dela parcele.</p> <p>5. KKA je dužna da donese poseban Okvir za rad, prema stavu 4. ovog člana, nakon stupanja na snagu ovog Administrativnog uputstva.</p> <p>6. U slučajevima kada se traži da se spoje imovine sa različitim vlasnicima, stvaranje suvlasništva se obavlja samo nad parcelom koja se stvorila spajanjem, koja se treba prethodno stvoriti (uspostaviti) sa pravosnažnim dokumentom, od nadležnog organa.</p>
--	--	---

<p>7. Me rastin e regjistrimit në kadastër të parcelave të reja të formuara, të gjitha ndërtesat mbi parcelat përkatëse duhet të regjistrohen nëse i plotësojnë kushtet sipas nenit 15 të këtij Ligjit nr. 04/L-013 për Kadastër.</p> <p style="text-align: center;">Neni 7 Numërimi i parcelave të krijuara me ndarje dhe bashkim</p> <p>1. Çdo parcelë e re e krijuar me ndarje ose bashkim merr numër të ri kadastral.</p> <p>2. Nurnri kadastral i parcelës në një zonë kadastrale përbëhet nga numrat e njëpasnjëshëm natyral të quajtur numrat amë, duke filluar prej një (1) të përcjellë me vijë (-) dhe zero (0) në regjistrimin e parë.</p> <p>3. Kur të ndahet parcela, parcelat e reja marrin numrin e ri, i cili përbëhet nga numri fillestar amë të përcjellë nga vija (-) dhe numri i njëpasnjëshëm i krijuar duke filluar nga një (1). Shembull: Nëse parcela me numër 10-0 ndahet në tri pjesë, parcelat e reja do të kenë numrat 10-1, 10-2, 10-3, kurse parcela 10-0 shkon në arkiv.</p>	<p>7. While registering the new parcels in cadaster, all the buildings over respective parcels should be registered if they met the conditions according to article 15 of this administrative instruction Law No. 04/L-013 on Cadastre.</p> <p style="text-align: center;">Article 7 The counting of the parcels created by division and merging</p> <p>1. Each new parcel created by division or merge receives a new cadastral number.</p> <p>2. The cadastral number of the parcel in a cadastral zone consists of consecutive natural numbers called matrix numbers, starting from number one (1) forwarded with hyphen (-) and zero (0) in the first registration.</p> <p>3. When the parcel is divided, new parcels take the new number which consists of initial matrix numbers forwarded by the hyphen (-) and the established consecutive number starting from number one (1). Sample: If the parcel with number 10-0 is divided in 3 parts, new parcels will have the numbers 10-1, 10-2, 10-3, whereas the parcel 10-0 gets archived.</p>	<p>7. Prilikom registracije novih formiranih parcela u katastar, potrebno je registrovati sve objekte u odgovarajućim parcelama, ako ispunjavaju uslove iz člana 15. ovog Administrativnog Uputstva Zakon br. 04/L-013 o Katastru.</p> <p style="text-align: center;">Član 7 Utvrđivanje brojeva stvorenih parcela deobom ili spajanjem</p> <p>1. Svaka nova parcela, stvorena cepanjem ili spajanjem, dobija novi katastarski broj.</p> <p>2. Katastarski broj parcele jedne katastarske zone sastoji se od prirodnih brojeva koji idu redom i zovu se matični brojevi, počev od broja jedan (1) nakon kojeg sledi crta (-) i nula (0) u prvoj registraciji.</p> <p>3. Kada se parcela deli, nove parcele dobijaju novi broj koji se sastoji od početnog matičnog broja, nakon kojeg sledi crta (-) i broj koji ide redom, koji je kreiran počev od broja jedan (1). Primer: Ako se parcela sa brojem 10-0 deli na 3 dela, nove parcele će imati brojeve 10-1, 10-2, 10-3. Dok parcela 10-0 ide u arhivu.</p>
---	--	--

<p>4. Kur parcela e ndarë ndahet përsëri, parcela e re merr numrin e ri i cili përbëhet nga numri fillestar amë të përcjellë nga vija (-) dhe numrin më të ulët natyror - të krijuar. Shembull: Nëse parcela 10-1 është ndarë në dy pjesë, ajo arkivohet, ndërsa parcelat e reja të formuara nga ndarja numërohen: 10- 3, 10-4.</p> <p>5. Nëse një parcelë kadastrale krijohet nëpërmjet bashkimit të dy apo më shumë parcelave fqinje, numrat e parcelave të përfshira në parcelën e re do të anulohen, ndërsa parcela e re merr një numër unik (numrin e parcelës), i cili do të jetë numri i fundit i përdorur plus 1 (një) i ZK-së. Shembull: Nëse parcela me nr. 10-0 bashkohet me parcelen m. 11-1, ndërsa numri i fundit i parcelës në ZK është 500, atëherë parcela e krijuar me bashkim shënohet me nr. 501.</p> <p style="text-align: center;">Neni 8 Shenjat e numërimit</p> <p>Për t'i shënuar parcelat përdoret vetëm shenja vizëlidhese (-) .</p>	<p>4. When the divided parcel gets divided again, the new parcel get the new number consisting of initial matrix numbers forwarded with an hyphen(-) and the smallest established natural number. Sample: If the parcel 10-1 is divided into two parts, she gets archived, whereas new parcels established from the division count: 10-3, 10-4.</p> <p>5. If a cadastral parcel is established through the joining of two or more neighboring parcels, the numbers of the included parcels will be canceled, whereas the new parcel gets a unique number (the parcel number), which will be the last used plus number 1 (one) of CO. Sample: If the parcel with number 10-0 gets combined with the parcel number 11-1, whereas the last parcel number in CO is 500, then the established parcel is marked with number 501.</p> <p style="text-align: center;">Article 8 Counting signs</p> <p>To mark the parcels only the hyphen (-) is used.</p>	<p>4. Kada se deljena parcela deli ponovo, nova parcela dobija novi broj koji se sastoji od početnog matičnog broja, nakon kojeg sledi crta (-) i zatim najmanji stvoreni prirodni broj. Primer: Ako se parcela 10-1 deli na dva dela, ona se arhivira, dok nove osnovane parcele dobijaju brojeve: 10-3, 10-4.</p> <p>5. Ako se katastarska parcela osnuje spajanjem dve ili više susednih parcela, brojevi parcela koje su spojene u novu parcelu biće otkazani, dok će nova parcela dobiti jedinstveni broj (broj parcele), koji će biti poslednji korišćeni broj plus 1 (jedan) KZ-a. Primer: Ako se parcela sa brojem 10-0 spaja sa parcelom 11-1, dok je poslednji broj parcele u ZK-u 500, onda se parcela osnovana spajanjem upisuje sa br. 501.</p> <p style="text-align: center;">Član 8 Oznake utvrđivanja brojeva</p> <p>Za označavanje parcela koristi se samo znak crtica (-).</p>
---	--	--

<p style="text-align: center;">Neni 9 Regjistrimi i të drejtave pronësore për parcelë</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Registration of property rights for the parcel</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Upis imovinskih prava za parcelu</p>
<p>1. Në kadastër regjistrohen të gjitha të drejtat pronësore të parapara me Ligjin nr. 2002/5 për Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronave të Paluajtshme, Ligjit me Nr. 04/L-009.</p> <p>2. Nuk mund të bëhet regjistrimi i të drejtave mbi një pjesë të pronës së paluajtshme në RDPP- SIKTK sipas Ligjit mbi Themelimin e Regjistrimit të të Drejtave mbi Pronën e Paluajtshme, Ligji Nr. 2002/5 dhe Ligjit Nr. 04/L-009 para se të bëhet formimi - ndarja e asaj pjese të pronës së paluajtshme dhe të regjistrohet në regjistër.</p> <p>3. Të dhënat për pronën që duhet të regjistrohet në regjistrin e të drejtave sipas dokumentit të plotfuqishëm duhet të jenë të njëjta me të dhënat që janë regjistruar në kadastër.</p> <p>4. Para regjistrimit të njësisë kadastrale në SIKTK për njësinë e pronës, duhet të hartohet raporti gjeodezik nga kompania gjeodete e licencuar, gjeodeti i licencuar apo tekniku gjeodet i licencuar.</p>	<p>1. In cadaster are registered all property rights foreseen with the Law no. 2002/5 for Establishment of Real Estate Register, Law No. 04/L-009.</p> <p>2. The registration of rights upon a part of real estate can not be conducted in RROP-CISLK according to Law No. 2002/5 and Law No. 04/L-009, before the establishment-division of that part of real estate is conducted and registered in register.</p> <p>3. Data for property that should be registered in rights' register according to almighty document should be the same with the data that are registered in cadaster.</p> <p>4. Before registration of cadastral unit in KCLIS for property unit, geodetic report should be drafted from the Licenced Surveying Company, Licensed Surveyor or Licensed Surveying Technican.</p>	<p>1. U katastar se upisuju sva imovinska prava koja su propisana Zakonom Br. 2002/5 o osnivanju registra o pravima nad nepokretnom imovinom te Zakonom Br. 04/L-009.</p> <p>2. Ne može se vršiti upis prava na jedan deo nepokretnosti u RPNI – SKIZK prema Zakonu o osnivanju registra o pravima na nepokretnu imovinu, Zakonom Br. 2002/5 i Zakonom Br. 04/L-009 pre nego se izvrši formiranje – cepanje tog dela nepokretne imovine, pa da se upiše u registar.</p> <p>3. Podaci o imovini koju treba upisati u registar prava prema pravosnažnom dokumentu treba biti isti sa podacima koji su upisani u katastar.</p> <p>4. Pre upisa katastarske jedinice u SKIZK za jedinicu imovine, potrebno je izraditi geodetski izveštaj od strane geodetske kompanije ili geodete.</p>

<p>5. Formati dhe përmbajta e raportit gjeodezik bëhet në pajtim Kornizën e Punës të nxjerrë nga AKK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 10 Regjistrimi i barrave dhe ngarkesave mbi të drejtat pronësore</p> <p>1. Të gjitha barrat dhe ngarkesat mbi të drejtat pronësore në një pronë të paluajtshme regjistrohen në vijueshmëri, sipas kohës në të cilën janë paraqitur në ZKK.</p> <p>2. Prioriteti i barrave dhe ngarkesave mbi të drejtat pronësore përcaktohet sipas datës dhe kohës së regjistrimit të tyre në regjistrin.</p> <p>3. Prioriteti mund të ndryshoj vetëm nëse për këtë ekziston marrëveshja e nënshkruar nga të gjitha palët e përfshira, e vërtetuar nga organi kompetent dhe e regjistruar në regjistrin e paluajtshmërive.</p> <p>4. Në rast se në një pronë të paluajtshme ekzistojnë të regjistruara dy e më tepër barra dhe ngarkesa me rastin e përmbushjes së detyrimit të barrës ose ngarkesës së parë, prioriteti caktohet sipas detyrës zyrtare me vendim të veçantë nga ZKK. Me këtë ndryshim njoftohen me shkrim ose në formë elektronike të gjitha palët e interesit.</p>	<p>5. Format and content of geodetic report is done in concordance with the Framework of Work issued by KCA.</p> <p style="text-align: center;">Article 10 Recording of cargos and burdens on property rights</p> <p>1. All cargos and charges on property rights in an immovable property are recorded in continuity, according to the time when they are presented to the MCO.</p> <p>2. The priority of burdens and charges on property rights is determined by the date and time of their registration in the Register.</p> <p>3. Priority can change only if for this there is an agreement signed by all parties involved, certified by the competent body and registered in the Immovable Registry.</p> <p>4. In case when in the immovable property are registered two or more charges and cargo, in this case the priority of fulfillment obligation of the charges or cargo, shall be determined ex officio by a special decision of the MCO. With this change all interested parties should be notified in writing or electronically.</p>	<p>5. Format i sadržaj geodetskog izveštaja izrađuju se u skladu sa Radnim okvirom, donetim od strane KKA-a.</p> <p style="text-align: center;">Član 10 Registracija ttereta i opterećenja nad imovinskim pravima</p> <p>1. Sva opterećenja i tereti za imovinska prava nad jednom nepokretnoj imovini registruju se u kontinuitetu, prema vremenu predaje u OKK-u.</p> <p>2. Prioritet tereta i opterećenja na imovinska prava određuje se prema datumu i vremenu upisa u registar.</p> <p>3. Prioritet se može mijenjati samo ako za to postoji sporazum potpisan od strane svih uključenih strana, ovjeren od strane nadležnog organa i registrovan u Registru nepokretne imovine.</p> <p>4. U slučaju da je nad jednom nepokretnom imovinom upisana dva ili više tereta i opterećenja, u slučaju ispunjenja obaveze prvog tereta ili opterećenja prioritet se određuje po službenoj dužnosti sa posebnom odlukom OKK. Za ovu promjenu obavještavaju se sve zainteresirane strane pismeno ili elektronski.</p>
---	--	---

<p align="center">Neni 11 Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekës</p>	<p align="center">Article 11 Registration, modification and cancellation of the mortgage</p>	<p align="center">Član 11. Registracija, modifikacija i brisanje hipoteke</p>
<p>1. Parashtrimi i kërkesës për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekës bëhet nga:</p> <p>1.1. Pengmarrësi ose i autorizuari i tij;</p> <p>1.2. Pengdhënësi ose i autorizuari i tij.</p> <p>2. Kërkesës për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekës, pala duhet t'ia bashkangjes dokumentin valid nga organi kompetent.</p> <p>3. Të dhënat e nevojshme për regjistrimin e hipotekës janë:</p> <p>3.1. për parashtruesin e kërkesës,</p> <p>3.2. shuma e hipotekës,</p> <p>3.3. data e skadimit të hipotekës,</p> <p>3.4. njësitë kadastrale që hyjnë në hipotekë,</p>	<p>1. The submission of a request for registration, modification and deletion of the mortgage must be made by:</p> <p>1.1. The pledgee or his authorized representative;</p> <p>1.2. The pledgor or his authorized representative.</p> <p>2. To the request for registration, modification and deletion of the mortgage, the party must attach the valid document to the competent body.</p> <p>3. The data required for the registration of the mortgage are:</p> <p>3.1. for the claimant,</p> <p>3.2. the amount of the mortgage,</p> <p>3.3. the date of the expiration of the mortgage,</p> <p>3.4. the cadastral units entering in the mortgage,</p>	<p>1. Podnošenje zahteva za registraciju, modifikaciju i brisanje hipoteke vrši se od:</p> <p>1.1. hipotekarni poverilac ili njegov ovlašćeni predstavnik;</p> <p>1.2. Hipotekarni dužnik ili njegov ovlašćeni predstavnik.</p> <p>2. Zahtev za registraciju, modifikaciju i brisanje hipoteke, stranka mora priložiti validni dokument nadležnom organu.</p> <p>3. Podaci potrebni za registraciju hipoteke su:</p> <p>3.1. za podnosioca zahteva,</p> <p>3.2. iznos hipoteke,</p> <p>3.3. datum isteka roka hipoteke,</p> <p>3.4. katastarske jedinice koje se unose u hipoteku,</p>

<p>3.5. kushtet, 3.6. afatet, 3.7. pengmarrësin, 3.8. pengdhënësin, 3.9. borxhliun dhe 3.10. prioriteti.</p> <p>4. Banka pas pranimit të aktvendimit nga ZKK, për konfirmim të shqyrtimit të kërkesës për regjistrim, modifikim dhe fshirje të hipotekës, obligohet të regjistroj të dhënat mbi hipotekën në sistemin elektronik bankar dhe të dërgoj të dhënat duke shfrytëzuar ueb shërbimin e AKK-së, të cilat pastaj shfrytëzohen nga ZKK për verifikim dhe regjistrim në SIKTK.</p> <p style="text-align: center;">Neni 12 Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e servitutit</p> <p>1. Parashtrimi i kërkesës për regjistrim, modifikim dhe fshirje të servitutit bëhet nga përfituesi i të drejtës së shfrytëzimit të servitutit duke ia bashkangjitur dokumentin valid nga organi kompetent.</p>	<p>3.5. terms, 3.6. deadlines, 3.7. pledgee, 3.8. pledgor, 3.9. debtor and 3.10. priority.</p> <p>4. The bank, upon receipt of the ruling by the MCO, for confirmation of the application examination for registration, modification and cancellation of the mortgage, is obliged to register the mortgage data in the electronic banking system and to send the data using the KCA web service, which are then used by the MCO for verification and registration at SIKTK.</p> <p style="text-align: center;">Article 12 Registration, modification and deletion of servitude</p> <p>1. Submission of the application for registration, modification and cancellation of the servitude, is done by the beneficiary of the right of exploitation of the servitude, attaching the valid document to the competent body.</p>	<p>3.5.uslovi, 3.6.rokovi, 3.7.zalogoprimac, 3.8.zalogodavac, 3.9.dužnika, i 3.10.prioriteta.</p> <p>4. Po prijemu rešenja od strane OKK, Banka je, nakon potvrde o razmatranju zahteva za upis, modifikaciju i brisanje hipoteke, dužna je da registruje podatke o hipoteci u sistemu elektronskog bankarstva i da ih pošalje putem web servisa u KKA, koje zatim koristi OKK za verifikaciju i upis u SKIZK-u.</p> <p style="text-align: center;">Član 12 Registracija, modifikacija i brisanje Servituta</p> <p>1. Podnošenje zahteva za upis, modifikaciju i brisanje servituta vrši korisnik prava na korištenje servituta, uz priloženje važećeg dokumenta od nadležnom organu.</p>
--	--	---

<p>2. Të dhënat e nevojshme për regjistrim, modifikim dhe fshirje të servitutit në regjistër janë:</p> <p>2.1. njësitë kadastrale (shërbyese dhe dominante),</p> <p>2.2. subjekti juridik (dominant),</p> <p>2.3. sipërfaqen e servitutit,</p> <p>2.4. elaboratin gjeodezik,</p> <p>2.5. llojin e servitutit,</p> <p>2.6. afatin dhe</p> <p>2.7. kushtet tjera të përcaktuara me dokument valid.</p>	<p>2.The necessary data for the registration, modification and cancellation of servitude in the register are:</p> <p>2.1. cadastral units (service and dominant),</p> <p>2.2. legal entity (dominant),</p> <p>2.3. servitude area,</p> <p>2.4. geodesic elaboration,</p> <p>2.5. type of servitude,</p> <p>2.6. deadline and</p> <p>2.7. other conditions defined by valid document.</p>	<p>2.Potrebni podaci za registraciju, modifikaciju i brisanje servituta u registru su:</p> <p>2.1. katastarske jedinice (uslužne i povlasne),</p> <p>2.2. pravno lice (povlasno),</p> <p>2.3. površina servituta,</p> <p>2.4. geodetska elaborat,</p> <p>2.5. vrsta servituta,</p> <p>2.6. rok i</p> <p>2.7. drugi uslovi definisani validnim dokumentom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Procedurat e regjistrimit të ndryshimeve në kadastër</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 The procedure for registration of changes in the cadaster</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Postupci upisa promena u katastar</p>
<p>1. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në kadastër bëhet me shkrim apo në formë elektronike në ZKK-në ku ndodhet njësia kadastrale, nga personi që ka interes juridik apo me autorizim të veçantë. ZKK protokolon kërkesën duke paraqitur numrin e protokolit, kohën dhe datën e pranimit të saj.</p> <p>2. Parashtruesi i kërkesës që kërkon regjistrimin e ndryshimit të njësisë kadastrale i'a bashkangjet kërkesës matjet kadastrale,</p>	<p>1. The request for registration of the changes in cadaster by the one who has legal interest or special authorization is done in writing and electronic form in MCO, where the cadastral unit is located. MCO archives the request by protocol number, time and admission date of protocol.</p> <p>2. The Applicant requesting the registration of the change of cadastral unit shall attach to the</p>	<p>1. Zahtev za registraciju promena u Katastar podnosi se pismeno ili u elektronskom obliku u OKK, u kojoj se nalazi katastarska jedinica, od strane lica koje ima pravni interes ili posebnim ovlašćenjem. OKK protokoliše zahtev podnošenjem broja protokola, vreme i datum prijema istog.</p> <p>2. Podnosilac zahteva koji zahteva registraciju promena katastarske jedinice, prilaže zahtevu</p>

<p>sipas udhëzimit administrativ për matjet kadastrale për regjistrim në kadastër dhe kornizave të punës të nxjerra nga AKK.</p> <p>3. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimit duhet të parashtrohet brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e përfundimit të matjes kadastrale.</p> <p>4. ZKK-ja shqyrton kërkesën e parashtruar dhe dokumentacionin e bashkëngjitur. Kur dokumentacioni nuk është i kompletuar, ZKK-ja kërkon nga parashtruesi i kërkesës që në afat prej 30 ditësh të bëjë plotësimin e dokumentacionit.</p> <p>5. Kur nuk plotësohet dokumentacioni brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 4 të këtij neni, , kërkesa refuzohet.</p> <p>6. ZKK-ja regjistron njësinë e re kadastrale, ose ndryshimet e të dhënave lidhur me njësinë ekzistuese, brenda afatit prej tri (3) ditë pune pas paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe informon parashtruesin e kërkesës për vendimin e saj.</p>	<p>request the cadastral measurements, in accordance with the Administrative Instruction on Cadastral Measures for Registration in the Cadastre and the working guidelines issued by the KCA.</p> <p>3. The request for registration of changes should be submitted within sixty days (60), from the day when cadastral measurements were finished.</p> <p>4. MCO will revise the submitted request and the attached documentation. When the documentation is not completed, MCO requires from the applicant of this request that within thirty (30) days to complete the documentation.</p> <p>5. If the documentation is not completed within the deadline of paragraph 4 of this article, the request will be rejected.</p> <p>6. MCO registers the new cadastral unit, or the changes of information related with the existent unit, within the deadline from three (3) business days. After revising the request for registration, MCO informs the applicant of this request about its decision.</p>	<p>i katastarske premere, prema Administrativnom uputstvu za katastarske premere za upis u katastar, te radnih okvira donetih od KKA-a.</p> <p>3. Zahtev za registraciju promene treba podneti u roku od šesdeset (60) dana, od dana završetka katastarskog premera.</p> <p>4. OKK razmatra podneseni zahtev i priloženu dokumentaciju. U slučaju da dokumentacije nije kompletna, OKK zahteva da podnosilac zahteva u roku od 30 dana dopunjava dokumentaciju.</p> <p>5. Ako u roku koji je utvrđen u stavu 4. ovog člana, nije dopunjena dokumentacija, zahtev se odbija.</p> <p>6. OKK registruje novu katastarsku jedinicu, ili promene podataka u vezi sa postojećom jedinicom, u roku od tri (3) radnih dana nakon podnošenja zahteva za registraciju i informiše podnosioca zahteva o svojoj odluci.</p>
---	---	---

<p>7. Regjistrimi nga paragrafi 6 i këtij neni hynë në fuqi me zbatimin e vendimit të ZKK-së në regjistrin e njësive kadastrale.</p> <p>8. Kur ZKK nuk e respekton afatin e paraparë në paragrafin 6 të këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë ankese për moszbatim të afatit ligjor sipas nenit 13, paragrafi 5 i Ligjit për Kadastër.</p> <p>9. AKK është e obliguar të vendos brenda afatit prej tre (3) ditësh, për ankesën sipas paragrafit 8 të këtij neni.</p>	<p>7. Registration from paragraph 6 of this article enters in force with the implementation of CO decision in registration of cadastral units.</p> <p>8. If MCO does not respect the deadline according to paragraph 6 of this article, the applicant of this request has the right to complaint for noncompliance of legal term according to article number 13, of 5 paragraph of Cadastral Law.</p> <p>9. KCA is obligated to make a decision within three (3) days related to complaint according to paragraph 8 of this article.</p>	<p>7. Registracija iz stava 6. ovog člana stupa na snagu sprovođenjem odluke OKK-a u registar katastarskih jedinica.</p> <p>8. Kada OKK ne poštuje rok, koji je propisan u stavu 6. ovog člana, podnosilac zahteva ima pravo na žalbu za nesprovođenje zakonskog roka, u skladu sa članom 13. stav 5. Zakona o katastru.</p> <p>9. Za žalbu iz stava 8. ovog člana, OKK je u obavezi da donosi odluku u roku od 3 dana.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Korrigjimi i regjistrin kadastral</p> <p>1. Nëse shënimet në kadastër konstatohen të pasakta – me gabime që kanë të bëjnë me shënimet për të dhënat personale të pronarit të regjistruar si: emrit, emrit të prindit, mbiemrit, numrit personal, vendlindjes dhe vendbanimit, për korrigjimin e tyre nevojiten dëshmi me shkrim, nëse i plotëson njërin nga kushtet e mëposhtme:</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Correction of cadastral registry</p> <p>1. If the information in cadaster is inaccurate – mistakes that are related to personal information of the registered owner, like: name, father’s name, surname, personal number, birthplace, and place of residence, they should be corrected. To correct the information there is a need of a written evidence, and also to complete one of the conditions below:</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Ispravke u katastarskom registru</p> <p>1. Ako se utvrdi da su katastarski podaci netačni – sa greškama koje se odnose na podatke o ličnim podacima registrovanog vlasnika, kao što su: ime, ime roditelja, prezime, lični broj, mesto rođenja i prebivalište, za njihovu ispravku potrebni su pismeni dokazi, ako ispunjava jedan od dole navedenih uslova:</p>

<p>1.1. dokumentin juridik në bazë të të cilit është regjistruar e drejta e cila kërkohet të korrigojohet ose</p> <p>1.1.1. dokumentet personale nga zyra e gjendjes civile që vërtetojnë të dhënat personale të personit të regjistruar në kadastrë se nuk është i njëjti me personin që kërkohet të bëhet korrigjimi;</p> <p>1.1.2. vërtetimin se personi i regjistruar në kadastrë nuk ekziston, të cilit duhet bashkangjitur edhe deklaratën nën betim të vërtetuar në organin kompetent të bashkëpronarit nëse kemi bashkëpronësi, ose deklaratën nën betim të vërtetuar në organin kompetent të ndonjërit nga pronarët fqinj të paluajtshëm për të cilën kërkohet korrigjimi i të dhënave personale ose</p> <p>1.2. dokument nga ndonjë organ tjetër kompetent, i cili e vërteton identitetin e personit, i cili kërkon korrigjimin e të dhënave personale.</p> <p>2. ZKK-ja, pas pranimit të kërkesës për korrigjimin e gabimit eventual në të dhënat e kadastrit, duhet të shqyrtoj kërkesën dhe</p>	<p>1.1. legal document according to which the right, that is requested to be corrected, is registered; or</p> <p>1.1.1. personal documents issuing by the registry office that prove that personal information of the person who is registered in the cadaster is not the same with the person that has requested to make the correction;</p> <p>1.1.2. a certificate that proves that the person who is registered in cadaster does not exist, to which the verified declaration of co-owner (or neighboring landowners), done under oath in the competent authority should be attached, if there is a co-ownership, for which the correction of personal data is requested; or</p> <p>1.2. Documents from another competent authority, which proves the identity of the person who has requested the correction of personal information.</p> <p>2. MCZ after receiving the request for correction of eventual mistakes in the cadastral information should revise the request within</p>	<p>1.1. pravni dokumenat na osnovu kojeg je registrovano pravo koja se traži da se ispravi; ili</p> <p>1.1.1. lične isprave iz kancelarije civilnog statusa koji potvrđuju da registrovano lice u katastar nije isto lice za koje se traži ispravka;</p> <p>1.1.2. potvrda da registrovano lice u katastar ne postoji, kojoj se treba priložiti i izjava pod zakletvom, koja je overena od nadležnog organa, suvlasnika ako imamo suvlasništvo, ili izjavu pod zakletvom, koja je overena od nadležnog organa, jednog od vlasnika susedne nepokretnosti, za koju se traži ispravka ličnih podataka; ili</p> <p>1.2. dokumenat bilo kojeg drugog nadležnog organa, koji potvrđuje identitet lica koje traži ispravku ličnih podataka.</p> <p>2. Po prijemu zahteva za ispravku eventualne greške u podacima katastra, OKK treba da razmotri zahtev i u roku od 15 dana od dana prijema zahteva, da donosi rešenje o izvršenim</p>
--	--	--

